



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 4 Shkurt 2022

Nr. 46

V E N D I M

P Ë R

**SHQYRTIMIN E KËRKESËS PËR REGJISTRIMIN E KOALICIONIT “SHTËPIA E LIRISË”, (SH-L) PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13 438, datë 20.01.2022, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të neneve 19, pikat 1, shkronja “n”, e 2, 65 dhe 66, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, të udhëzimit nr. 1, datë 23.12.2020, “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e dokumentacionit të kandidimit, afatet për publikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, të ndryshuar dhe të vendimit nr. 2, datë 22.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, të ndryshuar, pasi mori në shqyrtim kërkesën e Lëvizjes Socialiste për Integrim për regjistrimin si subjekt zgjedhor të koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 13 438, datë 20.01.2022, ka caktuar datën 6 Mars 2022, për zhvillimin e zgjedhjeve të pjesshme për Bashkinë Shkodër, Bashkinë Dibër, Bashkinë Durrës, Bashkinë Vorë, Bashkinë Rrogozhinë dhe Bashkinë Lushnjë.

Me shkresën nr. 435 Prot., datë 31.1.2022, Lëvizja Socialiste për Integrim, në cilësinë e partisë udhëheqëse të koalicionit, ka depozituar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve kërkesën për regjistrim të Koalicionit Zgjedhor me emër “Shtëpia e Lirisë”, për zgjedhjet e pjesshme vendore, të datës 6 Mars 2022.



Në kërkesën e paraqitur në KQZ, janë përcaktuar

1. Partitë përbërëse të koalicionit:
  - Lëvizja Socialiste për Integrim,
  - Partia Demokratike e Shqipërisë – Komiteti i Përkohshëm i Rithemelimit,
  - Partia Demokratiane.
2. Marrëveshja e koalicionit
3. Emri i koalicionit “Shtëpia e Lirisë” me shkronja nistore “Sh-L”
4. Sigla e koalicionit

Në seancën publike të zhvilluar në datën 4.2.2022, përfaqësuesi i autorizuar i Lëvizjes Socialiste për Integrim, z. Kaziaj, kërkoi regjistrimin si subjekt zgjedhor të koalicionit “Shtëpia e Lirisë”, me shkronja nistore “Sh-L” dhe me parti udhëheqëse subjektin zgjedhor LSI.

Përfaqësuesi i subjektit zgjedhor “Partia Demokratike”, z. Logu, ngriti pretendimin për mos legjitimitimin e kërkesës së paraqitur nga LSI, pasi në momentin e paraqitjes së kërkesës me shkrim, kjo parti politike nuk kishte fituar ende statusin (cilësimin) e subjektit zgjedhor të regjistruar në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve. Këtë status kjo parti e fitoi me vendimin e Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve, të datës 2 shkurt 2022. Duke qenë se kërkesa është paraqitur nga një subjekt që nuk ka legjitimitet për ta bërë atë, kërkesa duhet të rrëzohet, pretendon përfaqësuesi i Partisë Demokratike.

Veçmas kësaj përfaqësuesi i Partisë Demokratike pretendoi se edhe në përmbajtjen e saj kjo kërkesë është në kundërshtim me ligjin nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar – nga këtu e vijim referuar si Kodi Zgjedhor, përkatësisht nenin 66 të tij.

Sipas z. Logu kërkesa e LSI cënon drejtpërdrejt interesin e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” pasi në të kërkohet që të bëhet regjistrimi i një koalicioni zgjedhor me përbërjen e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Partisë Demokratiane dhe një subjekti me emërtimin Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit.

Sipas përfaqësuesit të PD përdorimi i emrit të kësaj partie nga një subjekt tjetër përbën shkelje të dispozitave të Kodit Zgjedhor, përkatësisht nenit 66 të tij. Vetë PD, pretendoi përfaqësuesi i saj, nuk është pjesë e asnjë koalicioni zgjedhor në këto zgjedhje dhe nuk ka asnjë vullnet për të hyrë në koalicion.

Në vlerësim të sa u pretendua nga përfaqësuesit e dy subjekteve zgjedhorë në lidhje me kërkesën objekt shqyrtimi dhe të dokumentacionit që ka shoqëruar këtë kërkesë, bërë ky vlerësim bazuar në Kodin Zgjedhor, çmuj se pretendimet e përfaqësuesit të Partisë Demokratike janë vetëm pjesërisht të mbështetura në këtë Kod.



Bazuar në nenin 65 të Kodit Zgjedhor, pranë KQZ janë regjistruar si subjekte zgjedhore për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetarë bashkie të datës 6 Mars 2022, krahas të tjerave edhe partitë politike si më poshtë vijon:

1. Partia politike “Lëvizja Socialiste për Integrim”, me Kryetar zj. Monika Kryemadhi, me vendimin nr. 34, datë 2.2.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.
2. Partia politike “Partia Demokristiane Shqipërisë”, me Kryetar z. Nard Ndoka, me vendimin nr.38, datë 2.2.2022, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve.

Neni 65, pika 1, i Kodit Zgjedhor përcakton kushtet për regjistrimin e një koalicioni zgjedhor:

1. Kushti i parë ligjor është ai që koalicion formohet vetëm nga parti politike.
2. Kushti i dytë ligjor është që partia politike të jetë regjistruar si subjekt zgjedhor në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve.
3. Kushti i tretë është numri i partive politike që mund të hyjnë në koalicion, i cili duhet të jetë dy ose më shumë.

Në shqyrtimin bërë sot të kërkesës për t’u regjistruar si koalicion, rezulton se kërkuesi, Lëvizja Socialiste për Integrim është regjistruar si subjekt zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme të datës 6 Mars 2022. Po kështu edhe Partia Demokristiane (PDK) është regjistruar si subjekt zgjedhor. Në këtë mënyrë kemi të përmbushur të tre kushtet ligjor të përcaktuara nga nenin 65 i Kodit Zgjedhor. Me vendimin nr. 2, datë 22.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022” afati për paraqitjen e kërkesave për regjistrimin e koalicioneve ka qenë data 3 shkurt 2022. Paraqitja e një kërkesë të tillë jashtë këtij afati do ta bënte kërkesën të rrëzueshme. Kjo kërkesë nuk është paraqitur jashtë këtij afati. Kjo është kërkesa e ligjit zgjedhor.

Dhe sikurse kemi thënë edhe pak më lartë, në shqyrtimin sot të kësaj kërkesë rezulton se LSI dhe PDK janë subjekt zgjedhor të regjistruar në KQZ. Përfaqësuesi ligjor i LSI konfirmoi kërkesën për regjistrimin e koalicionit zgjedhor të quajtur “Shtëpia e Lirisë”.

Si LSI, ashtu edhe PDK kanë paraqitur kërkesën për tu regjistruar si subjekt zgjedhor, respektivisht, që në datat 28 dhe 29 janar 2022. Kërkesa e LSI për t’u regjistruar si koalicion me PDK është paraqitur në datën 31 janar 2022. Pra, kjo kërkesa e fundit është paraqitur (jo jashtë afati), por “përpara afatit” dhe pasi ky subjekt dhe subjekti tjetër që përbën këtë koalicion e kanë shprehur interesin për të qenë subjekte zgjedhor



në zgjedhjet e datës 6 Mars 2022. Komisioneri mundet të kishte marrë vendimin për regjistrimin e tyre si subjekte zgjedhor nga data 28 deri në datën 31 janar 2022. Dhe me marrjen e këtij vendimi brenda 24 orëve sikurse përcakton vendimi nr. 2, datë 22.1.2022, i Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”, subjekti i interesuar, në këtë rast LSI dhe/ose PDK do të paraqisnin kërkesën sikurse është.

Nuk qëndron edhe pretendimi tjetër i përfaqësuesit të PD për ta kthyer kërkesën dhe dokumentacionin shoqërues për plotësim, pasi kërkesa ka të gjithë elementët dokumentarë të kërkuar nga nenet 65 dhe 66 të Kodit Zgjedhor.

E çmoj të bazuar pretendimin në lidhje me atë se kërkesa e LSI cënon drejtpërdrejt interesin e subjektit zgjedhor “Partia Demokratike” pasi sipas kësaj kërkesë kërkohet që të bëhet regjistrimi i një koalicioni zgjedhor me përbërjen e Lëvizjes Socialiste për Integrim, Partisë Demokristiane dhe një subjekti me emërtimin Partia Demokratike e Shqipërisë – Komisioni i Përkohshëm i Rithemelimit. Ky i fundit jo vetëm që nuk është regjistruar si subjekt zgjedhor, por nga ana tjetër përfshirja e një termi të tillë në koalicionin zgjedhor “Shtëpia e Lirisë” të përbërë nga LSI dhe PDK, qartazi vjen në kundërshtim me kërkesat e nenit 66 të Kodit Zgjedhor. Ky term është gati i njëjtë me emrin e subjektit zgjedhor Partia Demokratike e cila është pjesëmarrëse në zgjedhjet e 6 Mars 2022.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenet 19, pikat 1, shkronja “n” e 2, 65 dhe 66, të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në udhëzimin nr. 1, datë 23.12.2020 “Për përcaktimin e rregullave për depozitimin e verifikimin e listave të kandidatëve dhe miratimin e modeleve të kandidimit”, të ndryshuar dhe vendimin nr. 2, datë 22.1.2022, të Komisionit Rregullator, “Për miratimin e disa afateve procedurale që lidhen me zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”. të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

### **V E N D O S I:**

1. Të regjistrojë si subjekt zgjedhor pjesëmarrës në zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022, Koalicionin e partive politike Lëvizja Socialiste për Integrim dhe Partia Demokristiane e Shqipërisë.
2. Emri i koalicionit është “Shtëpia e Lirisë” me shkronja nistore “Sh-L”.
3. Partia udhëheqëse e koalicionit është “Lëvizja Socialiste për Integrim”.



4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzetë e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**  
**Ilirjan CELIBASHI**

